

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti për nevojat e shoqërisë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburant diesel - 09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 4.220.000 *(katër milion e dyqind e njëzet mijë)* **lekë pa T.V.Sh.**

Sasia e pritshme e mallit që kërkohet:

- Gazoil (Diesel)-10 ppm USLD – rreth **27.763** *(njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre)* Litra.

(bazuar dhe referuar llogaritjes së çmimit dhe sasisë).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale U.K. Dibër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 *(Për menaxhimin e cilësisë, e vlefshme)* ose ekuivalente me to, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme datën e hapjes së ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të

prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur në qoftë se Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e limit të kësaj kontrate, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, V.K.M. nr. 922 datë 29.12.2014, "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, etj.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përse i përket aftësisë teknike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më vogël se **20%** e vlerës të përlllogaritur të kontratës e cila prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit, nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore;

ose

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi, pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20% të vlerës limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me “Licencë” për stacionin e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikantë dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, (i ndryshuar), dhe V.K.M. nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Subjekti Ofertues duhet të disponojë stacione Karburanti në territorin e Qarkut Dibër, ku Autoriteti Kontraktor zhvillon aktivitet, në Bashkitë/Qytetet Bulqizë, Burrel, Peshkopi. Kjo kërkesë duhet vertetuar me një nga format e disponimit, sipas Kodit Civil (kontratë qiraje, kontratë furnizimi (bashkëpunimi) ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin tregtar të shoqërisë etj).Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B/C (sipas shtojcës 1 të ligjit 52/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar) Veprimtaria: Furnizim me karburant i makinave në një

stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B - Të gjitha instalimet), Vërtetim Teknik të lëshuar Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit, Akt-Teknik nga P.M.N.ZH., dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me pakicë. (Këto dokumenta duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë datën e hapjes së ofertave.)

Argumentimi: Duke qenë se Shoqëria Rajonale U.K. Dibër përveç automjeteve disponon edhe mjete si; (eskavator, fadrom, etj), është e nevojshme që subjekti ofertues të ketë minimalisht 1 (një) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit, me qëllim furnizimin e mjeteve efektive të tij. Para vendosjes së këtij kriteri NJHDT ka bërë hetim të tregut dhe ka konstatuar se më shumë se 1(një) operator ekonomik kanë minimalisht 1 (një) stacion te tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të të Qarkut Dibër në qytetet Bulqizë, Peshkopi dhe Burrel.

Gjithashtu lidhur me kërkesën që stacionet e furnizimit të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B (sipas shtojcës 1 të ligjit 52/2020, Veprimtaria: Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B - Të gjitha instalimet), **Vërtetim Teknik të lëshuar Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit**, dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me pakicë.

Argumentojmë se kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, duke garantuar në përfundim autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet te paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- a) Që ofron furnizimin me karburant 24 orë në 24 orë në të gjitha pikat e shitjes në Qarkun Dibër (në bashkitë/qytetet Bulqizë, Burrel, Peshkopi me pistoletë publike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.**
- b) Që merr persiper të ofroje tollona për Autoritetin Kontraktor të përdorshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës si dhe deri në përfundim të të gjitha sasive të litrave sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- c) Që merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.**

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit Nr.9947, datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme”, ... etj.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Në zbatim të neneve 36, 37 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.

Sqarim për ofertuesit: Në zbatim të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 82, dhe V.K.M.-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Nenet 26 dhe 39, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, Autoriteti Kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në Nenin 82, të LPP-së dhe Nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Në çdo rast, Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të noterizuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për objektin: ‘Blerje karburanti diesel (Gazoil 10ppm) Specifikimet teknike janë në përputhje me standartin shtetëror: **S.SH.EN 590:2022** (ose ekuivalent), sipas standardeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, që është Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri.

Specifikimet teknike gjenden pjesë përbërëse e D.T. në S.P.E. e A.P.P.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT